Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**26.09.2024**	**07.10.2024**	**2024/0858**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.09.2024, OE "EJONA SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0858, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Termo Solar Ingineering SH.P.K."- Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi dhe montimi I chilereve te rinj dhe termopompave ne ndertesast qeveritare" me nr. të prokurimit: "214-24-4897-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 194,500 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 28/05/2024

Hapja e ofertave: 10/07/2024

Vendimi i AK-së: 29/08/2024

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0858 i dt:16.09.2024.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

PRETENDIMI 1)

AK kerkon sqarime shtese per dokumente te cilat nuk kane qene kerkese e DT dhe as e Njoftimit per Kontrat, duke shkelur keshtu ***Nenin 72.***
perkatesisht, paragrafi 1) ***Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. dhe Neni 40 - RrPP paragrafi 40.2. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.***

Ne ju kemi pergjigjur AK me nje deklarate ku kemi saktesuar se kerkesa e tyre eshte ne kundershtim me LPP dhe RrPP si dhe kemi konfirmuar edhe njehere
se produktet dhe sherbimet e ofertuara jane ne perputhje te plote me specifikimet teknike, ashtu si edhe deklarata per specifikime teknike qe e kemi dorezuar para hapjes.

Poashtu kemi deklaruar se, katallogun do e dorezojme pas nenshkrimit te kontrates dhe vizites ne teren per aprovim nga AK ashtu edhe sic bejme ne te gjitha projektet tjera, e posaqerisht me kete AK.

PRETENDIMI 2)

AK shkel Nenin 59 te LPP dhe Nenin 40 te RrPP duke mos kryer Ekzaminimin, Vleresimin dhe krahasimin e tendereve sipas ligjit.
Pra, AK pervec se kerkon ndryshime te dokumenteve para hapjes AK poashtu shton kritere te reja gjate ekzaminimit, vleresimit dhe krahasimit te tendereve, dhe i perdor ato kritere te sajuara per eliminimin tone nga gara, veprim ky plotesisht i ndaluar nga LPP.

AK me vendimin e shpallur shkele plotesisht Nenin 59 dhe 40 duke vleresuar ofertat ne baze te kritereve qe nuk kane qene ne DT dhe as ne Njoftimin per Kontrat,
dhe per te njejtat kritere eliminon nga gara dy OE qe kane ofertuar me cmim me te ulet dhe e shpalle fitues OE me cmim me te larte se ne prej 35,188.12euro duke demtuar keshtu direkt buxhetin e RKS.

AK poashtu shpall fitues nje OE i cili ka dorezuar katalog mirepo, i njejti nuk i ploteson kerkesat minimale te produktit te kerkuar.

PRETENDIMI 3)

AK shkel Nenin 56, paragrafi 3 duke na diskualifikuar nga gara ne baze te nje kriteri i cili nuk eshte cekur ne DT dhe Njoftim per Kontrat.

PERFUNDIM:

Kerkojme nga OSHP qe te anuloje vendimin e shpallur, te ktheje lenden ne rivleresim dhe te detyroje AK te beje Ekzaminimin, vleresimin dhe krahasimin sipas LPP dhe RrPP.
Kjo tashme eshte lenda e dyte qe e kemi dorezuar ne OSHP per te njejtin AK dhe per te njejtat arsye te eliminimit, andaj keto veprime te AK duket se jane shume tendencioze ndaj nesh!

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional **1. 1(Një) Inxhinier i dip. të Elektronikës (ose bechelor) me 2(dy) vite pervojë pune.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Diplomat përkatëse e notorizuar nga origjinali, me notorizim 2.kontrata ose marrëveshje e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt - kopje; 3.Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme, në lëmin e kërkuar.**
2.1(Një) Inxhinier të Makinerisë - TermoEnergjetikë (ose bechelor) me 2(dy) vite pervojë pune.	**1.Diplomat përkatëse e notorizuar nga origjinali, me notorizim 2.kontrata ose marrëveshje e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt - kopje; 3.Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme, në lëmin e kërkuar.**
3. 1(Një) Inxhinier Mekatronik (bechelor) me 1(një) vit pervojë pune.	**1.Diplomat përkatëse e notorizuar nga origjinali, me notorizim 2.kontrata ose marrëveshje e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt - kopje; 3.Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme, në lëmin e kërkuar.**
4.2(dy) Teknik	**1.kontrata ose marrëveshje e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt -kopje**
6.Operatorët ekonomikë ose Grupi i OE pjesëmarrës, duhet të kenë kontrata të realizuara për furnizime të ngjashme, shuma e të cilave duhet te jenë minimum 100,000.00 Euro të realizuar në tri vitet e shkuara para datës së publikimit te këtij njoftimi për kontratë.	**4. Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Listës duhet t'i bashkëngjiten dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i furnizimeve për kontratat dhe projektet e cekura në listë, (kopje).**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosoves

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve te Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Departamenti i Prokurimit / Departman za Javnu Nabavku / Department of Procurement

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: "Furnizimi dhe montimi I chilereve te rinj dhe termopompave ne ndertesast qeveritare"

Nr. i Prokurimit[2]	**214-24-4897-1-1-1**

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertave
1	Green Engineering SH.P.K., Orizë,Nr.6, 50000, Gjakovë	166800.00
2	" EJONA " SH.P.K., Zahaq, 30000, Peja	114444.88
3	**Termo Solar Ingineering SH.P.K., Rr. Zekë Bajraktari, p.n, Suharekë**	**149633.00**
4	EGO ELSA SH.P.K., Rruga e Pejes, pn , Llapllaselle, 10000, Kosove	147500.00

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Ministria e Punëve të Brendshme shpërblen me kontratë operatorin **Termo Solar Ingineering SH.P.K., Rr. Zekë Bajraktari, p.n, Suharekë** në vlerë totale të ofertës në shumë prej 149,633.00 **Euro .**

Data: 29.08.2024

Emri dhe mbiemri i ZPP: Agim ISLAMI

[1] Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde te njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojes).

Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES 1

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" EJONA " SH.P.K.**

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së. Pretendimet e ngritura nga OE ankues janë shqyrtuar dhe për të njëjtat, sipas mendimit të tij eksperti ka dhënë përgjigje si në vazhdim.

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që: *"AK na ka eleminuar duke vlerësuar ofertat në bazë të kritereve që nuk kanë qenë pjesë në DT dhe as në Njoftimin për Kontratë. AK kërkon sqarime shtesë për dokumente të cilat nuk kanë qenë kërkesë e DT-së dhe as Njoftimit për kontratë. Ne kemi deklaruar se katalogun do e dorëzojmë pas nënshkrimit të kontratës dhe vizitës në teren për aprovim nga AK ashtu siç bëjmë me të gjitha projektet tjera e posaqarisht me këtë AK."*

Eksperti shqyrtues sqaron që sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, AK në asnjë kërkesë nuk ka potencuar se operatorët ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë edhe katalogun/broshurën apo specifikacionin teknik për produktet e ofertuara. Kërkesa të tilla nuk janë parë as në Aneksi 1-Specifikimet teknike të detyrueshme. AK me datën 22/07/2024 ka dërguar një letër standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, përmes të cilit autoriteti ka kërkuar nga OE ankues dhe operatorët tjerë që të dorëzojnë katalogët nga prodhuesi për pozicionet 1-6 së bashku me përshkrimin e karakteristikave të produkteve.

Si përgjigje ndaj kësaj kërkese OE ankues me datën 25/07/2024 ka dorëzuar një deklaratë përmes të cilës ndër të tjerash thuhet se pas konsultimit me KRPP-në ju rikujtojmë se AK ka të drejtë të kërkoj informacione shtesë vetëm për dokumentet të cilat janë kërkuar dhe për dokumentet që janë paraqitur gjatë fazës së tenderimit dhe se pas nënshkrimit të kontratës katalogjet do të dorëzohen për aprovim për produktet e ofertuara.

Sipas nenit 56 të Ligjit për Prokurimin Publik, pika 3 e këtij neni ku thuhet se asnjë tenderues nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, atëherë edhe mendimi i ekspertit shqyrtues është se në rastin konkret AK nuk duhet të kërkoj sqarime për kritere shtesë dhe i njëjti nuk ka të drejtë të eleminoj operatorët ofertues në bazë të

kritereve të reja të cilat më herët nuk kanë qenë pjesë e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.

Megjithatë, duke marrë parasysh natyrën e aktivitetit të prokurimit, përmes të cilit autoriteti kontraktues edhe pse në dosje nuk e ka përfshirë këtë kërkesë, sipas mendimit të ekspertit është e vështirë për AK-në që të vlerësoj ofertat duke mos e pasur të qartë as prodhuesin dhe as modelin e produkteve me të cilat ofertohet. Në rastin konkret sipas ekspertit konsiderojmë që nëse AK nuk ka të drejtë të shtoj kërkesa të cilat nuk kanë qenë në NJK dhe DT, atëherë të paktën operatori ankues mund të dorëzoj një deklaratë me të cilën sqaron se cilit prodhues dhe cilit model i takojnë produktet me të cilat ka ofertuar. Nga kjo çfarë sqaruam konsiderojmë që pretendimi i ngritur është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 2

"AK shpallë fitues një OE i cili ka dorëzuar katalog mirëpo i njëjti nuk i plotëson kërkesat minimale të produktit të kërkuar."

Sa i përket këtij pretendimi, OE ankues në ankesë nuk ka qenë aspak i qartë se cilat kërkesa të cilit produkt nuk i plotëson katalogu i dërguar përmes sqarimeve shtesë nga ana e operatorit të rekomanduar, megjithatë në dokumentet e ofruara si dëshmi eksperti ka pare se janë shtjelluar disa specifika të disa produkteve për të cilat edhe AK ka dhënë përgjigje se i ka dhënë qasje OE ankues gabimisht vetëm në njërin katalog andaj sipas tyre edhe pretendimet e ngritura janë bazuar në katalogun e gabuar. Në këtë rast eksperti vlerëson që pas kthimit të lëndës në rivlerësim duhet që të njëjtit ti ofroj qasje edhe në katalogun e dytë në mënyrë që të ngriten pretendimet konkrete duke u bazuar në katalogjet adekuate. Në rastin konkret konsiderojmë që ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 3

"AK shkel Nenin 56, paragrafi 3 duke na diskualifikuar nga gara ne baze te nje kriteri i cili nuk eshte cekur ne DT dhe Njoftim per Kontrat."

Për këtë çështje eksperti shqyrtues ka dhënë përgjigje në pretendimin e parë dhe e njëjta përgjigje vlenë edhe në këtë pretendim të ngritur.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" EJONA " SH.P.K.**

Agnese Ibrahimi